



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 127/
3 Prot.

Tiranë, më 7/3 /2013

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Plani Veprimit të Rekomandimeve të miratuara.

Drejtuar: SEKRETARIATIT,

NISMA PER TRANSPARENCE NE INDRUSTRINE NXJERRESE.

Znj. DORINA ÇINARI, DREJTORE

TIRANË

E nderuar znj. Çinari !

Nga data 05.09.2013 deri më 13.09.2013, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë ka zhvilluar një mision auditimi në Sekretariati, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, mbështetur në shkresën me nr. 7070 prot, datë 26.08.2013, "Njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit" dhe programit të auditimit me nr. 7070/1 prot, date 05.09.2013 për vlerësimin e veprimtarisë, për realizimin e objektivave në institucionin tuaj, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse, për periudhën 01.01.2012 - 31.12.2012.

Ne përfundim të investigimit, grupi i auditimit mbajti Projekt Raportin e Auditimit dhe e dorezoje me nr. 127prot, date 26.09.2013. Grupit të auditimit, nuk ju paraqiten observacione nga pala e audituar dhe me kalimin e afateve ligjore, grupi i auditimit përgatiti raportin përfundimtar të auditimit.

Per mangesite e konstatuara, ne mbeshtetje te nenit 21, pika 7 te Ligjit nr. 9720, date 23.04.2007 " Per auditin e brendshem ne sektorin publik ", ndryshuar me Ligjin nr.10318, date 16.09.2010, te pikes 4.4 " Raportimi i rekomandimeve ", te Manualit te Auditimit te Brendshem ne Sektorin Publik, miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave me Nr 69, date 29.09.2010, per permiresimin e problemeve dhe sistemeve, jane dhene rekomandimet perkatese, te cilat jane paraqitur dhe perfshire ne nje Plan Veprimi, bashkelidhur.

I. Ne zbatim te Urdherit nr. 70, date 18.04.2006 te Kryeministrit, te kerkesave te pikes 3.2.3 "Pergjegjesia e organizates per te zbatuar rekomandimet e auditimit te brendshem ", te Manualit te Auditimit te Brendshem Publik (miratuar me Urdherin e Ministrit te Financave Nr 69, date 29.09.2010), ~~Drejtoria e "Koncesioneve, Prokurimeve, Shpronësimeve dhe Privatizimit"~~, te informoje zyrtarisht Drejtorine e Auditimit te Brendshem, mbi analizen e raportit te auditimit, marrjen e masave dhe programimin e detajuar te detyrave.

II. Drejtoria e Sekretariatit, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, ne zbatim te Pikes III/1, te urdherit te mesiperm, te hartojne me shkrim raportin mbi zbatimin e planit te veprimit, per zbatimin e rekomandimeve, jo me vonë se 10 dite nga data e plotesimit te afateve te caktuara ne planin e veprimit. Nje kopje e raportit te dergohet dhe ne D.A.B.

III. Ne zbatim te kerkesave te Ligjit nr.9720, date 23.04.2007" Per auditimin e brendshem ne sektorin publik ", i ndryshuar dhe te pikes 4.4 dhe 4.7 te Manualit te Auditimit te Brendshem, dergohet bashkelidhur Raporti Perfundimtar i Auditimit dhe Plani i Veprimit te rekomandimeve te miratuara, mbi auditimin e kryer ne Sekretariati, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

Duke Ju falenderuar per bashkepunimin .

DREJTOR

ARMAND REVELI




Plan veprimi lidhur me rekomandimet

Ne perfundim te misionit te auditimit, dergimit te Projekt Raportit me detyrat perkatese me nr. 127 prot, date 26.09.2013 dhe Raportit final te auditimit, grupi i auditit pergatiti plan veprimin lidhur me rekomandimet:

Nr.	Rekomandimet	Niveli i riskut.	Referenca e paragrafit ne raport	Reagimi i menaxhimit	Afati i percaktuar
1	Të hartohen Bilanci kontabël dhe Pasqyrat financiare për vitin 2012, dhe të depozitohet në Degën e Thesarit, Tiranë, dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.	I larte	Faqe nr.1 dhe 9 <i>Faktorja bilancau 2012. Selicent zyrtore Tiranë</i>		Brenda muajit Mars 2014.
2	Sekretariat, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në bashkëpunim me Grupin Ndëristitucional, të bashkëpunojnë për të bërë të mundur, gjetjen e burimeve të financimit, për caktimin e grupit të auditimit, për të bërë mundur raportimin vjetor, pranë organizmit ndërkombëtar (EITI), në mënyrë që të mospërrjashtohet nga ky Organizëm.	I larte	Faqe nr.1 dhe 6		Menjehere dhe ne vazhdimesi.

A U D I T U E S I

Nexhmedin Dingo



RAPORT FINAL AUDITIMI

I. Permbledhje ekzekutive.

Bazuar ne planin vjetor te miratuar nga Ministri i ish-METE, të shkresës nr.7070, datë 26.08.2013 "Për fillimin e angazhimit të auditimit", dhe shkresës nr. 7070/1, datë 05.09.2013 "Program Angazhim Auditimi" u realizua auditim i plote pranë, Sekretariatit, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, Tiranë.

Auditimi u krye nga grupi i punes i perbere nga:

1. Flori Alla, pergjegjes grupi.
2. Nexhmedin Dingo, specialist auditi.

Periudha e audituar: janar 2012 – 31.12.2012.

Afati i auditimit: 05.09.2013 – 13.09.2013.

Metoda e auditimit: Auditim mbi baze sistemi.

Teknika e kryerjes se auditimit: Me perzgjedhje.

Objekti i auditimit: Zbatimi i ligjeshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësimi i veprimtarisë të Sekretariatit, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, Tiranë, për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2012.

Auditimi i sistemeve per periudhen objekt auditimi, per te vleresuar saktesine e regjistrimeve financiare, kryerjen e veprimeve ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi, funksionimin e kontroleve te brendshme si dhe te siguroje menaxhimin se keto kontrole po funksionojne per permbushjen e objektiveve me kosto efektive dhe ne menyre eficente.

Ne program u perfshine 7 sisteme per auditim si dhe probleme te tjera gjate auditimit.

Ne perfundim te auditimit vleresojme se te gjithë sistemet e audituara kane funksionuar mire me perjashtim te sistemit te kontabilitetit dhe te funksionimit te Sekretariatit.

Ne sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar, rezulton se nuk eshte mbyllur bilanci kontabel (Pasqyrat Financiare) te fund vitit 2012, dhe si rrjedhim, të pa depozituar në Degën e Thesarit, Tirane, dhe Ministrinë e Energjetikës dhe Industrise, veprim që bie në kundërshtimin me Ligjin Nr. 9228 datë 29.4.2004 "Për mbajtjen e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare", dhe Udhëzimit të Ministrit të Ministrisë Financave "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2012".

Ne sistemin e funksionimit te sekretariatit, rezulton se nuk është caktuar grupi i eksperteve për të bërë raportin vjetor për vitin 2012.

Vleresimi i riskut.

Mosfunksioni i kontrollit te brendshem ne sistemin e kontabilitetit dhe funksionimin e Sekretariatit, kane bere qe veprimtaria dhe funksionimi i subjektit te audituar, ka evidentuar nje risk ne nivel te larte, ne perbushjen e veprimtarise se tij.

Lidhur me gjetjet e konstatuara nga ana jone ne perfundim te auditimit, jane lene rekomandimet perkatese te cilat permiresojne funksionimin e entitetit.

II. Hyrje.

Auditimi ne Sekretariati, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, Tiranë, eshte realizuar mbeshtetur ne procedurat e percaktuara ne Manualin Specifik te Auditimit te Brendshem per METE, miratuar me Urdhërin e ish- Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nr.501, datë 15.06.2012 "Për miratimin e manualit specifik dhe kartës së auditimit të brendshëm në Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" dhe ne perputhje me Standartet Nderkombetare per Praktiken Profesionale te Auditimit te Brendshem.

Sekretariati, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, Tiranë, eshte ent publik dhe financohet nga,

- nga buxheti i shtetit;
 - nga pale te treta te destinuara per programin EITI nga fonde te institucioneve nderkombetare;
- te cilat i perdor per shpenzimet operative dhe kapitale.

Bazuar ne raportet e meparshme te auditimit, takimin fillestar organizuar me perfaqesuesit e institucionit, aktet ligjore te cilet rregullojne veprimtarine e tij, u identifikuan sistemet per auditim.

Ne perfundim te punes ne terren, u evidentuan gjetjet sipas rasteve, u vleresua funksionimi i kontrollit te brendshem per cdo sistem si dhe u dhane rekomandimet e duhura per permiresimin e funksionimit te tyre; me qellim qe objektivat te permbushen me kosto efektive dhe ne menyre eficente.

Ne kete menyre, grupi i punes permbushi objektivat e vena.

III. Objektivat e auditimit.

Auditimi i plote ne Sekretariati, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, Tiranë, bazohet ne Ligjin nr. 9720, date 23.04.2007 "Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin Publik", te ndryshuar dhe ne planin vjetor 2013 te miratuar nga Ministri i ish- METE me shkrese nr. 9066 prot, date 15.10.2012.

Ne programin e auditimit miratuar me shkresë nr. 7070/1 prot., date 05.09.2013, për cdo sistem u përcaktuan qarte objektivat, të cilat kanë të bëjnë me:

-vlerësimin nëse këto sisteme po veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoriatit, vlerësimin e dispozitave ligjore për përdorimin e fondeve buxhetore, ruajtjen dokumentimit dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, për menaxhimin dhe burimeve njerezore dhe pagesat;

-udhëzimet, urdherat dhe objektivat e vendosura nga ish-METE, rregulloren dhe brendshmen dhe strukturën organizative të miratuar.

IV. Objekti i auditimit dhe metodologjia.

Objekti i auditimit u caktuan sistemet të cilat u identifikuan në programin e angazhimit, bazuar në shqyrtimin e dosjes së auditimit të mëparshëm, në takimin fillestar të organizuar me përfaqësuesit e institucionit në datë 02.09.2013 si dhe me vlerësimin e riskut për cdo sistem.

Në programin e auditimit u përfshinë të gjitha sistemet e identifikuar që në fillim të misionit, si më poshtë:

Sistemi i zbatimit të rekomandimeve.

Sistemi i organizimit dhe menaxhimit të entitetit.

Sistemi i përdorimit të fondeve buxhetore.

Sistemi administrimit të asetëve.

Sistemi i veprimeve me likuiditetet.

Sistemi për mardhëniet e punës dhe pagat.

Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Metoda e përzgjedhjes në mënyrë rastësore u kombinua dhe me teknika të tjera si kontrolli aritmetik (liste pagesat, përlogaritjen e pagave, faturat, situacionet etj), shqyrtimi i dokumentave justifikuese e krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimin analitik (në të gjithë sistemet e audituara sipas programit).

V. Gjetjet dhe konkluzionet.

1. Sistemi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Fushat të cilat u morën në konsideratë gjatë auditimit:

Analiza e rekomandimeve të lëna nga auditimi mëparshëm, nga drejtusi i Institucionit.

Përcaktimi i personave përkates për realizimin e rekomandimeve.

Përcaktimi i afatëve për realizimin e rekomandimeve dhe raportimi i realizimit të detyrave.

Nga grupi i auditimit u konstatua se rekomandimet e lena nga auditimi meparshem, jane ndjekur te gjitha rekomandimet e lena, nga 7 rekomandime te lena jane realizuar plotesisht 5 prej tyre dhe dy jane ne proces.

2. Sistemi mbi vlerësimin e veprimtarisë së Sekretariatit.

Fushat te cilat u moren ne konsiderate gjate auditimit:
Organizimi dhe funksionimi i Sekretariatit,
Realizimi i Objektivave.
Organizimi i Kontrollit të Brendshëm.

Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.540, datë 07.07.2010 "Për ngritjen dhe funksionimin e sekretariatit, për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në nismen për transparencë në industrinë nxjerrëse", si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 975, datë 01.12.2010 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 07.07.2010", në të cilat është përcaktuar statusi i këtij entiteti, misioni, objektivat e tij, format e financimit, format dhe nivelet e raportimit.

Misioni: përcaktuar është, realizimi i anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), dhe pas këtij anëtarësimi, përgatitja e raporteve vjetore deklarimit te te ardhurave, në bashkëpunim me Grupin Ndërinstitucional të Punës.

Statusi ekonomik: me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 975, datë 01.12.2010, është përcaktuar ent publik.

Burimet e financimit, jane nga :

- buxheti i shtetit;
- pale te treta te destinuar per programin EITI nga fonde te institucioneve nderkombetare;
- subjekte fizike ose juridike, nga sektori privat, vendas dhe te huaj.

Detyrat dhe objektivat e sekretariatit janë:

Ngritja dhe mirëfunksionimi i infrastrukturës së nevojshme, në mbështetje të programit të veprimeve, të miratuar për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse;

Rishikimi i bazës ligjore për të evidentuar pengesat e mundshme për zbatimin e EITI-së.

Hartimi i raporteve vjetore dhe i raportit të vlerësimit, auditimit të raportit dhe plotësimi i procedurave për hartimin e raportit të vlerësimit, si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

Identifikimi i burimeve të qëndrueshme të financimit për zbatimin e EITI-së dhe monitorimi i tyre.

Përzgjedhja dhe sigurimi i përgatitjes profesionale të personelit të nevojshëm, në mbështetje të programit të veprimit të EITI-së, në fazat e ndryshme të saj.

Funksionimi i strukturave, në realizimin e detyrave dhe objektivave.

Nga grupi auditimit rezultoi se për periudhën objekt auditimi;

Në bazë të rekomandimeve të grupit vlerësues të EITI-t, është hartuar program pune 3-vjeçar, 2011-2013, për proceset dhe punën e EITI-t, në Shqipëri, si dhe janë përcaktuar objektivat për tu realizuar.

Sekretariati i ALBEITI, ka punuar duke u mbështetur në afatet dhe objektivat e Planit të Punës 2011-2013, i përmirësuar në bazë të rekomandimeve të bëra nga Sekretariati EITI.

Sekretariati i ALBEITI, ka studiuar dhe prezantuar të MSG materialin për tipet e pagesave kryesore që do të përfshihen në Raportin e Rakordimit vitit 2010.

Janë përfunduar negociatat dhe firmosur MOU me Kompanitë e Naftës Albpetrol, Bankers dhe Strim OIL që zënë rreth 100 % të të ardhurave në këtë Sektor.

Sekretariati ALBEITI, ka ndjekur procedurat për seleksionimin e firmës që do të përgatise dhe rakordojë të dhënat e raportit EITI viti 2010.

Sekretariati ALBEITI, ka kontaktuar me DPT dhe DPD, eksperte të auditimit (IEKA), për zbatimin e standarteve ndërkombëtare të auditimit në bilancet financiare të kompanive që punojnë në Industrinë Nxjerrëse.

Organizimi i kontrollit të brendshëm.

Në zbatim të pikës, 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 540, datë 07.07.2010 dhe pikës 5 të Urdhërit Nr. 896 datë 21.12.2010 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ndryshuar me Urdhërin Nr. 530, datë 18.07.2011 të Ministrit të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, evidentohet se për realizimin e objektivave dhe detyrave funksionale të stafit organizativ, si element i organizimit të kontrollit të brendshëm, është bërë ndarja e detyrave për çdo pozicion dhe emërtim të strukturës dhe është miratuar Rregullorja e Brendshme e Sekretariatit ALBEITI, me Urdhërin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Nr.20, datë 20.01.2012 "Për miratimin e Rregullores Brendshme Për Organizimin dhe Funksionimin e Sekretariatit, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse" (ALBEITI).

Funksionimi i Grupit Nderinstitucional: Për vitin 2012 Grupi Nderinstitucional, ka funksionuar konform dispozitave ligjore dhe ka marrë Vendimet përkatëse për problematiken e Inspektoriatit.

Funksionimi i kontrollit të brendshëm.

Për këtë fushë auditimi, nga grupi auditimit rezultoi se: Nga ana e Stafit të Sekretariatit dhe Grupit Nderinstitucional të Punës, në kuader

te ndjekjes te procedurave te anetaresimit te Shqiperise si vend zbatues ne nismen per transparence ne Industrine nxjerrëse ka bashkëpunuar dhe raportuar në mënyrë periodike, për punën e bërë nga Sekretariati dhe Grupi Ndërinstitucional i Punës, për ecurine e procesit, ka pergatitur programin e punes ne realizim te objektivave, dhe ka kordinuar programin e veprimeve per ceshtjet e EITI sipas afateve te caktuara per vitin 2012, konformë pikes 6 e 12, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.540, datë 07.07.2010 "Për ngritjen dhe funksionimin e sekretariatit, për ndjekjen e procedurave të anetarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në nismen për transparencë në industrinë nxjerrëse".

Për kete periudhe auditimi, nga grupi auditimit, **u konstatua** se nuk është caktuar grupi i eksperteve për të bërë raportin vjetor për vitin 2012, pasi nuk janë çelur fonde nga Banka Botërore dhe fondet e dhena nga Buxheti i Shtetit, kanë qenë për një pjesë të pagave të punonjësve.

3.Sistemi për përdorimin e fondeve buxhetore sipas destinacionit dhe qëllimit të miratuar.

Fushat te cilat u moren ne konsiderate gjate auditimit:

Programimi i buxhetit dhe dokumentimi i ketij procesi.

Detajimi i fondeve buxhetore per cdo ze.

Kryerja e shpenzimeve në përputhje me destinacionin sipas Buxhetit të miratuar.

Monitorimi dhe Raportimi për realizimin e shpenzimeve Buxhetore, per periudhat 3-mujore dhe vjetore.

Nga auditimi lidhur me programimin e buxhetit, detajimin e tij, ndjekjen dhe raportimin e fondeve buxhetore, nuk rezultuan gjetje.

Ne fund te cdo periudhe tre mujore eshte raportuar realizimi i buxhetit per te gjitha zerat e shpenzimeve si per fondet e alokuara nga buxheti i shtetit pasi per kete periudhe auditimi nuk ka pasur fonde te akorduara nga organizmat nderkombetare.

Fondet buxhetore për vitin 2012, kane qene ne Shumen 7.000.000 leke, në artikullin nr. 230.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2012, janë realizuar në Shumën 6.759.584, lekë, kundrejt planit vjetor 7.000.000 lekë, pra më pak nga plani vjetor, për shumën 240.416 lekë ose në masën 97 %.

Në totalin e shpenzimeve të entitetit, peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet për shërbime: për pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetsore.

Artikulli "Paga", janë realizuar në Shumën 3.915.009 lekë.

Artikulli "Sigurime Shoqërore + Tatami i të atdhurave personale", janë realizuar në Shumën 2.479.440, lekë.

Artikulli "Shpërblime", janë realizuar në Shumën 63.000 lekë.

Artikulli "Shpenzime operative, telefonon, Internet, energji dhe shpenzime postare", janë realizuar në Shumën 302.135, lekë.

Funksionimi i kontrollit te brendshem.

Per kete sistem vleresojme, fondet buxhetore për periudhën objekt auditimi, janë ndjekur, konform ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr.10487, datë 05.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012, si dhe Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" dhe Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.2/1, datë 15.02.2012 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012".

4.Sistemi për administrimin, ruajtjen dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare.

Fushat te cilat u moren ne konsiderate gjate auditimit:

Zbatimi i rregullave për evidentimin, qarkullimin, levizjen dhe ruajtjen e mallrave e mjeteve monetare.

Kryerja e inventarizimit të arkës dhe magazines, evidentimi i deferencave dhe sistemimi i tyre.

Nga auditimi lidhur me administrimin, ruajtjen dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, nuk rezultuan gjetje.

Me urdhërin nr.31, datë 25.12.2012 te Drejtuesit të Sekretariatit, është ngritur komisioni i Inventarizimit, konform ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë, 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Për Inventarizimin e vlerave materiale, dokumentacioni është plotësuar konformë dispozitave të mësipërme. Janë evidentuar inventari në përdorim për cdo punonjës si dhe inventari në magazinën e Institucionit.

Funksionimi i kontrollit te brendshem.

Për periudhën objekt auditimi, grupi auditimit vlereson se Sekretariati, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse" (ALBEITI), në drejtim te sistemit të administrimit, dokumentimit, ruajtjes dhe qarkullimin të vlerave materiale e monetare, ka respektuar ligjin nr.9228, date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndyshimet përkatëse, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë, 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

5.Sistemi i veprimeve dhe operacioneve me likujditete.

Fushat te cilat u moren ne konsiderate gjate auditimit:

Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të Ardhurat", me ndryshimet përkatëse.

7.Sistemi mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Fushat të cilat u moren në konsideratë gjatë auditimit:
Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit konform planit kontabël të miratuar për Institucionet.

Respektimi i kërkesave ligjore për raportimin financiar.

Në drejtim të mbajtjes të kontabilitetit në përputhje me kërkesat e Ligjit 9228 datë 29.4.2004 "Për mbajtjen e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare", nga auditimi evidentohet se :

Kontabiliteti në entitetit aktualisht ka filluar të mbahet me programin "ALFA".

Në entitet është mbajtur dhe administruar dokumentacioni rregullt ekonomik-financiar për ngjarjet ekonomike dhe transaksionet financiare të kryera.

Vlerat pasurore të ndërmarrjes aktiveve të qëndrueshme të trupezuara dhe gjendjet në magazinë dhe në përdorim, janë të mbështetura në dokumentacion blerës dhe libra të magazines.

Llogaritë monetare "disponibilitete në banka", rezultojnë në fund të periudhës së auditimit 31.12.2012, në përputhje me konfermat bankare, aktrakordimeve me Degën e Thesarit.

Nga auditimi lidhur me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit në këtë institucion u konstatua gjetje, si vijon;

Për vitin 2012, **rezulton pa mbyllur Bilanci kontabel**, dhe si rrjedhim, pa depozituar në Degën e Thesarit, Tiranë, dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, veprim që bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9228 datë 29.4.2004 "Për mbajtjen e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare", dhe Udhëzimit të Ministrit të Ministrisë Financave "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2012".

Për sa më lart përgjegjësi direkte mban ish- përgjegjëse sektorit të financës znj. Arta Luzi si dhe ish-Drejtuësi i Sekretariatit, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, z. Shkelqim Hysaj.

VI.Rekomandimet e auditimit.

Në përfundim të punës në terren, grupi i auditimit përgatiti projekt raport auditimit dhe planin e veprimit lidhur me rekomandimet dhe e dergoi atë zyrtarisht në subjektin e audituar, me nr. 127 prot, datë 26.09.2013.

Zbatimi me rigorizitet i këtyre rekomandimeve do të bëjë të mundur vendosjen e kontrolleve të duhura si dhe do t'i japë siguri

menaxhimit se keto kontrole po funksionojne per permbushjen e objektivave me kosto efektive dhe ne menyre eficente.

VII.Komentet e subjektit te audituar.

Pala e audituar nuk beri verejtje per projekt raportin e auditimit dhe nuk dergoi ne Drejtorine e Auditimit te Brendshem ne MEI, nje kopje te projekt raportit te nenshkruar nga ana e tyre, me apo pa verejtje. Gjithashtu nuk dergoi njoftim per takim permbylles.

Me kalimin e afateve ligjore, per kthimin e projekt raportit, grupi i auditimit pergatiti raportin perfundimtar te auditimit.

Pergjegjesja e sektorit te finances eshte larguar nga detyra qe ne muajin prill te vitit 2013 dhe Drejtuesi i Sekretariatit Shkelqim Hysa eshte liruar nga detyra me date 08.01.2014, me Urdher te Kryeministrit.

VIII.Falenderime.

Per permbushjen e objektivave te auditimit, grupi i punes falenderon stafin e Sekretariat, Nisma per Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, per gadishmerine qe treguan per venien ne dispozicion te dokumentacionit, suportin logjistik dhe bashkepunimin gjate gjithe kohes se auditimit.

Raporti final i auditimit hartohet ne kater kopje, prej te cilave nje kopje i dergohet institucionit te audituar, nje kopje ruhet ne protokoll, nje kopje ruhet ne dosjen e auditimit dhe nje kopje dergohet prane Njesise Qendrore te Harmonizimit per AB, ne Ministrine e Financave.

Audituesi

Nexhmedin DINGO

